VENDIM
Nr. 185, datë 25.2.2015

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AKADEMISË SË SIGURISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 41, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 37, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizimin e Akademisë së Sigurisë, si institucion përgjegjës i vetëm i arsimit të lartë publik policor, që ka për mision formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit e për personat fizikë e juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike.

2. Akademia e Sigurisë është institucion në përbërje të Policisë së Shtetit. Ajo zhvillon veprimtarinë mësimore e kërkimore në funksion të nevojave që ka Policia e Shtetit.

3. Akademia e Sigurisë përgjigjet për:

a) Formimin bazë të punonjësve të nivelit bazë të Policisë së Shtetit;

b) përgatitjen e specialistëve të lartë të Policisë së Shtetit në të tria ciklet e studimeve universitare;

c) kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit;

ç) zhvillimin e kërkimeve e të studimeve në fushën e policimit dhe të sigurisë;

d) ofrimin e specializimeve dhe kualifikimeve për institucione të tjera të zbatimit të ligjit dhe për personat fizikë e punonjësit e personave juridikë në fushën e rendit e të sigurisë publike.

4. Organizimi i Akademisë së Sigurisë bëhet në përshtatje me përgjegjësitë ligjore të ngarkuara dhe llojet e programeve mësimore që ofrohen, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe për Policinë e Shtetit.

5. Njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë janë:

a) Fakulteti i Sigurisë Publike;

b) fakulteti i Hetimit të Krimit;

c) Qendra Kërkimore Shkencore.

6. Struktura organike e Akademisë së Sigurisë miratohet nga ministri i Punëve të Brendshme me propozim të drejtorit të Policisë së Shtetit.

7. Statuti i Akademisë së Sigurisë miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

8. Organet dhe autoritetet drejtuese të Akademisë së Sigurisë organizohen e funksionojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon arsimin e lartë publik dhe organizimin e Policisë së Shtetit.

9. Akademia e Sigurisë ofron programe studimi për:

a) kualifikimin dhe specializimin e strukturave të sigurisë publike;

b) formimin, kualifikimin dhe specializimin e specialistëve në fushën e policimit dhe sigurisë në të tria ciklet e studimeve universitare;

c) kualifikimin dhe specializimin e punonjësve të agjencive të tjera të policimit, si dhe të punonjësve të personave fizikë e juridikë në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.

10. Hapja e programeve të reja të studimeve të të gjitha cikleve, riorganizimi dhe mbyllja e tyre bëhen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe të ministrit të Punëve të Brendshme.

11. Miratimi i programeve të formimit bazë dhe i kuotave bëhet nga drejtori i Policisë së Shtetit.

12. Pranimet e studentëve në Akademinë e Sigurisë, në të gjitha programet e studimit, për ciklin e parë të studimeve, bëhen me konkurs të hapur.

13. Kohëzgjatja e programeve të studimit dhe kreditet për çdo program studimi përcaktohen në statutin e Akademisë së Sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë.

14. Afatet për kualifikimet e vazhdueshme dhe ato të karrierës për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit përcaktohen nga drejtori i Policisë së Shtetit.

15. Afatet për trajnimet e punonjësve të agjencive të tjera të policimit dhe subjekteve private përcaktohen në marrëveshjet përkatëse.

16. Format e studimeve që aplikohen në Akademinë e Sigurisë janë studime me kohë të plotë. Mënyrat konkrete normohen në statutin e Akademisë së Sigurisë.

17. Akademia e Policisë ka flamurin dhe stemën e vet identifikuese, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

18. Akademia e Sigurisë është njësi shpenzuese në përbërje të programit buxhetor "Policia e Shtetit".

19. Akademia e Sigurisë, për realizimin e përgjegjësive të saj, bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, organizmat ndërkombëtarë dhe institucionet homologe të huaja, si dhe organizatat joqeveritare të interesuara në fushën e rendit e të sigurisë publike.

20. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama